

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-184-185/14**

Prishtinë, 18 maj 2016

Në çështjen juridike të:

**D. J.**

**Pala ankuese**

Kundër

**Askush**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtaret: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/RA/220/2013 (lëndët e regjistruar në AKP me numrat KPA54074 dhe KPA54076) të datës 27 Nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 18 maj 2016, mori këtë:

**AKTGJYKIM:**

1. Ankesat e paraqitura nga D. J., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-184/2014 dhe GSK-KPA-A-185/2014 që kanë të bëjnë me lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA54074 dhe KPA54076 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-185/14
2. Refuzohen si të pa bazuar ankesat e D. J. e paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 Nëntor 2013 për sa i përket kërkesave të regjistruara me numrat KPA354074 dhe KPA54076.
3. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/220/2013 të datës 27 Nëntor 2013 për sa i përket kërkesave KP54074 dhe KPA54076.

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 16 Nëntor 2007 D. J. (ne tekstin e mëtejme: pala ankuese), ne cilësinë e bartësit te pretenduar te se drejtës pronësore ka paraqitur në AKP kërkesën KPA54074 me te cilën kërkonte riposedimin mbi ngastrën kadastrale me numër 825/2, në vendin e quajtur “Gropa- kërshi”, komuna kadastrale Pakashticë e Epërme/Gornja Pakaštica, me sipërfaqe prej 5.51.99 h, me kulturë mal i klasit të III-të të cilën pretendon se e ka fituar me trashigimi nga i ati dhe ate në pjesën e ½-ve të 1/10 e pjesës së trashigimisë së të atit M. S. dhe kërkesën KPA54076 me të cilën kërkonte ngastrën kadastrale 866 në vendin e quajtur “Bjeshka”, komuna kadastrale Pakashticë e Epërme/Gornja Pakaštica, me sipërfaqe prej 2.55.50 h me kulturë mal i klasit të IV-të të cilën pretendon se e ka fituar me trashigimi nga i ati dhe ate në pjesën e ½-ve të 1/10 e pjesës së trashëgimisë së të atit M. S.
2. Për të mbështetur kërkesat e saj, pala përgjegjëse në ankese ka dorëzuar këto dokumente:
  - Aktvendimin trashigimor O.Br. 77/89 datë 14 Gusht 1989 lëshuar nga Gjykata Komunale në Podujevë me të cilin i ati i paraqitëses së ankesës M.S shpallej trashigimtar i ¼ të pasurisë së tërësishme të të ndjerit D. S. që evidentohet në listën poseduese Nr. 48 Zona Kadastrale Pakashticë e Epërme/Gornja Pakastica, pa e specifikuar ngastrën me numër 825/2 .
  - Aktvendimi i trashëgimisë O.br.818/07 date 25 Prill 2004 i lëshuar nga Gjykata Komunale ne Beograd, qe dëshmon se pala ankuese ka trashëguar bashkë me D. S. ½ e 1/10 –ve etë ngastreave kadastrale 825/2 dhe 866.

- Përshkrim i listës poseduese 197 lëshuar nga arkiva e dislokuar e shërbimit kadastral në Podujevë me date 25 Dhjetor 2006 që dëshmon se babai i paraqitëses së ankesës është bashkpronar i pjesës idale prej 1/10 të pronës së kërkuar
- Letërnjoftim i lëshuar nga autoritetet e Beogradit-Komuna e Rakovicës me 11 Nëntor 2005
- Kopje e certifikatës së martesës lëshuar nga regjistri martesor në Beograd me 04 Dhjetor 2006 që dëshmon se D. J. e vajzërisë S. është e bija e M.
- Certifikate e vdekjes datë 03.10.2001 që dëshmon se M. S. ka vdekur me 2 Tetor 2001 .
- Njësia e verifikimit kishte gjetur sipas detyrës zyrtare Fletën Poseduese nr.103, date 19 Gusht 2009 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Podujevës që tregon se prona e kërkuar ishte evidentuar si pronë shoqërore e regjistruar në emër të Ndermarrjes Publike Pyjore “Javor”-Podujevë

<b>Numri i ankesës dhe numri i lëndës së AKP-së</b>	<b>Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar</b>
GSK-KPA-A-184/14 (KPA54074)	Ngastra kadastrale me nr 825/2, në vendin e quajtur “Gropa- kërshi”, komuna kadastrale Pakashticë e Epërme/Gornja Pakaštica, me sipërfaqe prej 5.51.99 h, me kulturë mal i klasit të III-të
GSK-KPA-185/14 (KPA54076)	Ngastra kadastrale me nr. 866 në vendin e quajtur “Bjeshka”, komuna kadastrale Pakashticë e Epërme/Gornja Pakaštica, me sipërfaqe prej 2.55.50 h me kulturë mal i klasit të IV-të

3. Pronat ëshin verifikuar fizikisht më 11 Qershor 2008. AKP-ja ka bërë njoftimin duke vendosur shenjat në pronat e kërkuara dhe ka konstatuar se prona është identifikuar saktësisht përmes ortofotos dhe GPS kordinatave dhe ishte publikuar me 01 Korrik 2010 në Gazetën e Agjencisë përmes zyrave të UNHCR-së në Beograd
4. Askush nuk ishte paraqitur që ta kundërshtoi kërkesë
5. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), bazuar në provat e dorëzuara nga palët, me Vendimin KPCC/D/A/220/2013, të datës 27 Nëntor 2013, që i referohet lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KP54074 dhe KP54076, ka vendosur që kërkesa të refuzohet, me arsyetim se paraqitësi i kërkesës fillimisht kishte deklaruar se e ka humbur posëdimin si pasojë e konfliktit të armatosur por në bazë të dokumentave të parashtruara dhe kërkimeve “ex officio” të Sekretariatit ka rezultuar se prona është shoqërore dhe i përket ndërmarrjes publike të pyjeve “Javor” Podujevë.

### **Bashkimi i ankesave:**

6. Neni 13.4 i Rregullores se UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mund të vendos mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i lejon Komisionit të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave në mënyrë që të shqyrtojë dhe merr vendime aty ku ka çështje të njëjta ligjore si dhe të provave.
7. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Civile që janë të zbatueshme në procedura para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozita e nenit 408.1 në vështrim të nenit 193 të Ligjit nr. 03/L006 të Procedurës Kontestimore, ofrojnë mundësinë e bashkimit të kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efikasitetin e gjykatës dhe zvoglimin e kohëzgjatjes dhe shpenzimeve të procedurës.
8. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm që janë paraqitur ankesat, faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë saktësisht të njëjta në të dya lëndët. Vetëm ngastrat, subjekti i së drejtës pronësore që pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat janë të bazuara në deklaratë të njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjtë.
9. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-184/2014 dhe GSK-KPA-A-185/2014 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-184/2014
10. D. J. (në deshmitë e regjistrave civil J) në cilësinë e palës ankuese, vendimin e Komisionit e ka pranuar më 16 Prill 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 12 Maj 2014.

**Pranueshmëria e ankesave:**

11. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejshëm LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e afatëshme .

**Pretendimet Ankimore**

12. Pala ankuese pretendon se prona e kërkuar ka qenë në pronësi e bsabait të saj dhe është i pasaktë konstatimi se humbja e posedimit nuk është pasojë e konfliktit sepse prona është humbur si rezultat i konfliktit të armatosur dhe i rrethanave që lidhen me të. Ajo pretendon se prona e saj nuk ka pas status

të pronës shoqërore dhe këtë e ka dëshmuar me dokumentat e bashkangjitur kërkesës Për këtë arsye ajo kërkon që Vendimi i Komisionit të shfuqizohet dhe Gjykata të vërtetoi pronësinë mbi pronën e kërkuar dhe të urdheroi kthimin e posedimit.

### ***Meritat e Ankesës***

13. Vendimin KPCC/D/A/220/2013, të datës 27 Nëntor 2013 në paragrafin 18 thekson se paraqitësi i kërkesës nuk ka mundur të dëshmoi se humbja e posedimit përfshinë rrethanat që ndërlidhën drejtëpërsë drejti ose që rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999 dhe si e tillë bie jashtë mandatit të Komisionit.
14. Mandati i i Agjencisë dhe Komisionit është të shqyrtohen lëndët “që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999”. Kjo do të thotë se fushëveprimi i ekzaminimit të AKP-së është verifikimi i këtyre elementeve: kush ishte në posedim të pronës së kërkuar para 27 shkurtit 1998, kush është në posedim të saj tani, kur dhe për çfarë arsye është humbur posedimi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Formulimi i nenit 3.1 “*të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur*” nënkupton lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të humbjes së posedimit dhe konfliktit të armatosur ose lidhjen e ngushtë të shkakut dhe pasojës e cila në lëndën konkrete mungon.
15. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme në shkresa të lëndës ka mjaft elemente që tregojnë se prona ka qenë e evidentuar si shoqërore dhe i përkiste Ndremarrjës Pyjore “Javor” të Podujevës. Për këtë arsye konstatimi i palës ankuese sa i përket posedimit të pronës së kërkuar para ose gjatë konfliktit duhet të konsiderohet se është në mospërputhje me provat e dorëzuara.
16. Kjo e bën Gjykatën Supreme të arrijë në përfundim se çështja e kërkesës bie jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe ankesa e palës ankuese të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i apeluar i KKPK-së të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar le Ligjin nr. 03/L-079.
17. Për këto arsye të lartëcekurat, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

### **Këshillë ligjore:**

18. Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit,**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it**